



VENDIM MBI PAPRANUESHMËRI

Data e miratimit: 4 tetor 2012

Numri i lëndës: 2012-04

Izet Maxhera

Kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 4 tetor 2012, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese
Znj. Verginia MICHEVA-RUSEVA, anëtare
Z. Guénaël METTRAUX, anëtar

Ndihmuar nga
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor
Znj. Joanna MARSZALIK, zyrtare ligjore
Z. Florian RAZESBERGER, zyrtar ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetorit 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe Rregullores së Punës së Panelit me 9 qershor 2010,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

I. PROCEDURAT PRANË PANELIT

1. Ankesa është regjistruar më 5 prill 2012.

II. FAKTET

1. Faktet e lëndës, ashtu siç janë parashtruar nga parashtruesi i ankesës, dhe siç paraqiten nga dokumentet që iu kanë dorëzuar Panelit, mund të përmbliken si në vijim.
2. Në një datë të pacaktuar të vitit 2011 Agjencia Kosovare për Privatizim (AKP) kishte vënë në tender publik një ngastër të tokës, e cila më herët i përkiste të së ashtuquajturës ndërmarrje shoqërore Kosovasirovina në Mitrovicë.
3. Këto objekte në atë kohë ishin të zëna nga EULEX-i duke u mbështetur në Memorandumin e Mirëkuptimit të nënshkruar nga EULEX-i dhe UNMIK-u.
4. Më 21 shtator 2011 parashtruesi i ankesës ka fituar tenderin. Më 11 janar 2012 ai ka nënshkruar një marrëveshje me AKP-në dhe ngastrën e tokës në fjalë e kishte fituar me qiramarrje afatgjate.
5. Më 24 janar 2012 parashtruesi i ankesës ka shkruar EULE-it një letër përmes postës elektronike, duke i propozuar që palët të arrijnë një marrëveshje rreth çmimit të qiradhënies për ato objekte. Një ditë më vonë ai ka pranuar një përgjigje nga zyra e EULEX-it e shefit të personelit, i cili i ka kërkuar atij që të ofroj dokumentet që e shpallin atë titullar të ngastrës. Parashtruesi i ankesës i ka ofruar kopjet e marrëveshjes së shitjes, hartën e pronës dhe certifikatën për të drejtat në pronën e paluajtshme nga Agjencia Kadastrale e Kosovës. Në përgjigje, zyra e EULEX-it e drejtorit të administratës dhe mbështetjes kanë kërkuar nga ai që të ofroj një "certifikatë nga gjykata rreth marrëveshjes për blerje" e parashikuar në nenin 36(2) dhe 287(2) e ligjit nr. 03/L-154 lidhur me të drejtat në pronësi dhe drejtat e tjera pronësore.
6. Më 5 mars 2012 parashtruesi i ankesës ka kërkuar nga gjykata komunale e Mitrovicës që të certifikoj të drejtën e tij në ngastrën në fjalë. Sidoqoftë, siç e shpjegon ai në një letër përmes postës elektronike drejtuar Sekretariatit të Panelit më 1 qershor 2012, ai ishte njoftuar se gjykata nuk lëshon certifikata të tilla.
7. Më 19 prill 2012 parashtruesi i ankesës ka dërguar një letër tjetër përmes postës elektronike në EULEX, duke shpjeguar se nenet e cituara për ligjin mbi pronën dhe të drejtat e tjera nuk zbatohen në rastin e tij, pasi ai nuk e kishte blerë ngastrën në fjalë, por ai e kishte marrë atë me qira afatgjate. Marrëveshja me Agjencinë Kosovare të Privatizimit ishte e mjaftueshme për t'i ofruar atij të drejtën civile lidhur me ngastrën në fjalë. Ai vë në pah se ai ishte regjistruar si qiramarrës në zyrën kadastrale të Mitrovicës. Ai ka parashtruar një kopje të certifikatës në lidhje me këtë.
8. Më 27 gusht 2012 parashtruesi i ankesës dhe EULEX-i kanë nënshkruar një marrëveshje për qiradhënie. Parashtruesi i ankesës i

ka lëshuar me qira ngastrën e kontestuar të tokës EULEX-it, që nga data 11 janar 2012 deri më 14 qershor 2013.

III. ANKESAT

9. Parashtruesi i ankesës pretendon se e drejta e tij për gëzimin paqësor të pronës ishte i shkelur nga EULEX-i që i kishte zënë pronën e tokës së tij pa ndonjë bazë ligjore. Ai përmend nenin 1 të protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (Konventa).

IV. LIGJI

10. Para shqyrtimit të meritave të ankesës, Paneli duhet të vendos nëse do ta pranoj ankesën, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me rregullën 29 të rregullores së vet të punës.
11. Sipas rregullës 25, paragrafit 1 të rregullores së vet të punës, Paneli mund të shqyrtojë ankesat që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të njeriut nga ana e EULEX-i në Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv.
12. Sidoqoftë, Paneli konstaton se është e panevojshme në këtë rast që të përcaktohet se a hyn kjo ankesë në kuadër të mandatit. Paneli konstaton se është rregulluar çështja rreth së cilës ka pasur ankesë. Parashtruesi i ankesës ka nënshkruar një marrëveshje për qiradhënie me EULEX-in, prej datës kur ai kishte siguruar të drejtat në ngastrën në fjalë, bazuar në kontratën afatgjate që është arritur midis parashtruesit të ankesës dhe AKP-së.
13. Prandaj, Paneli është i kënaqur që EULEX-i ka njohur të drejtat e parashtruesit të ankesës dhe se ka marrë përsipër që ta paguaj qiranë për shfrytëzimin e pronës së tij.

PËR KËTO ARSYE, PANELI NJËZËRI

konstaton se kjo ankesë është e pabazuar sipas nenit 29 (d) të rregullores së vet të punës, dhe

SHPALL ANKESËN TË PAPRANUESHME.

Për Panelin,

John J. RYAN
Zyrtar i lartë ligjor

Magda MIERZEWSKA
Kryesuese